



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Komisioni i Pavarur i Medieve (KPM) duke u bazuar në Rregulloren për Vlerësimin e Aplikacioneve për Licencë të KPM-së KPM-2014/02, përkatësisht në nenin 4, paragrafi 7, me qëllim të vlerësimit të aplikacioneve, të pranuar në konkursin publik për licencë të radios në gjuhën turke për Komunën e Prizrenit të shpallur më 28 shtator 2022 dhe i cili ka qenë i hapur deri më 28 tetor 2022, në mbledhjen e mbajtur me datën 23 qershor 2023, merr këtë:


VENDIM

THEMELOHET KOMISIONI PËR VLERSIMIN E APLIKACIONEVE PËR LICENCË TË KPM-SË

**I.
PËRBERJA**

Komisioni do të funksionoj në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve:

- znj. Azra Dešić, Anëtare e KPM-së - Anëtare;
- z. Nuredin Islami, Drejtor i Departamentit të Licencimit - Kryesues;
- z. Mirand Tafarshiku, Drejtor i Departamentit të Monitorimit dhe Analizës- Anëtar;
- znj. Ganimete Nuçi, Zëvendësuese e Drejtorit të Departamentit të Administratës dhe Financave - Anëtare;
- z. Besim Rexhepi, Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Frekuencave – Anëtar.



**II.
VLERËSIMI**

Vlerësimi i aplikacioneve për licencë do të behet në pajtim me kriteret e përcaktuara në Ligjin e KPM-së, Rregulloren për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Adiovizuale, Rregulloren për Vlerësimin e Aplikacioneve dhe në pajtim me kriteret e Konkursit Publik.

Aplikacionet e kandidatëve duhet të vlerësohen me poenë, për secilin nga kriteret e përgjithshme, në pajtueshmëri me Rregulloren për Vlerësimin e Aplikacioneve për Licencë të KPM-së (Rregullorja KPM-2014/02).

Anëtarët e Komisionit për Vlerësimin e Aplikacioneve do ta bëjnë vlerësimin e aplikacioneve brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi dhe duhet të përpiloj raportin përfundimtar, të

vlerësimin të aplikacioneve, i cili duhet të jetë i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit për Vlerësimin e Aplikacioneve.

IV TERMAT E REFERENCËS


Komisioni Vlerësues i aplikacioneve në takimi e parë të tij lidhur me vlerësimin e aplikacioneve do të miratojë termat e referencës.

III ARSYETIM

KPM, me datën 19 shtator 2022, ka marr vendim për shpalljen e konkursin publik për dhënien e një licence për shërbim medial audio (radio) në gjuhën boshnjake, me mbulim lokal, në lokacionin Vitomiricë, Komuna e Pejës, si dhe një licence të radios në gjuhën turke, me mbulim regjional, për Komunën e Prizrenit. Konkursi është publikuar më datën 28 shtator 2022 dhe ka qenë i hapur për dorëzimin e aplikacioneve deri më datën 28 tetor 2022, ora 16:00.

KPM, me qëllim të vlerësimin të aplikacioneve të pranuar gjatë konkursit publik, bazuar në nenin 4, paragrafi 7, të Rregullores KPM-2014/02, i cili parasheh formimin e Komisionit për Vlerësimin e aplikacioneve, vendosi si në dispozitivin e këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Jeton Mehmeti

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



6.7.2023
data